



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJËRAVE
Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Tel: 270 630, Fax: 270 627, www.moe.gov.al

Tiranë, më 08.07.2009

RREGULLORE

(Nr. 3, datë 08.07.2009)

PËR
ÇERTIFIKIMIN E SHËRBIMEVE TË EKSPERTIZËS DHE PROFESIONALE NE PYJE DHE
KULLOTA (KATEGORIA II. 7 . A)

Në mbështetje të nenit 102 te Kushtetutes dhe te neneve 15 dhe 52 pika 2, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, te Vendimit te Këshillit te Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, miraton këtë rregullore:

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është:
 - a. identifikimi dhe klasifikimi i veprimtarive te ekspertizes dhe profesionale ne pyje e kullota;
 - b. përcaktimi i organit përgjegjës dhe i procedurave për miratimin e ushtrimit te tyre nga specialistet e pyjeve; që do të kryejnë veprimtari studimi e projektimi ne pyje e kullota,
2. Zbatimi i kërkesave te kësaj rregulloreje është i detyrueshëm për çdo person juridik ose fizik, vendas ose të huaj që do të ushtrorjë veprimtari studimi, projektimi dhe zbatimi për investimet në pyje dhe kullota me fonde publike e private në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht formës së organizimit të tij.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje termat kanë këto kuptime:

1. “**Veprimtari**” si ne ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 ”Per lejet, licensat dhe autorizimet ne Republikën e Shqiperise”
2. “**Certifikatë**” është dokument shtetëror si ne ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 ”Per lejet, licensat dhe autorizimet ne Republikën e Shqiperise”
3. “**Specialist pyjesh**” Inxhinier Pyjesh i diplomuar në Fakultetin e Shkencave Pyjore që është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarive në përputhje me kushtet teknike të kryerjes studimit, projektimit dhe zbatimit te tyre.

4. “Klasifikim” - Klasifikimi i veprimtarive ne fushën ”Shërbime te ekspertizës dhe/ose profesionale ne pyjet apo kullotat”.

Neni 3

Klasifikimi i shërbimeve qe certifikohen

1. Shërbimet e ekspertizës dhe/ose profesionale ne pyjet apo kullotat” klasifikohen ne:

- a) **Shërbime te ekspertizës:** Supervizim, mbikëqyrje, kolaudime dhe certifikime te ndryshme te shërbimeve profesionale, te prodhimit dhe/ose tregtimi i farave, kalemave dhe fidanëve pyjor, te materialit mbjellës
- b) **Shërbime profesionale për studime e aplikime profesionale:** hartimi i metodologjive, udhëzuesve/manualeve me përmbajtje thellësisht teknike, studime për përdorimin e territorit, zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor dhe vlerësimin e peizazheve, biodiversitetin, zonat e mbrojtura, parqet kombëtare, florën spontane (bimët aromatike mjekësore e tanifere), faunën e egër, të rritit të burimeve gjenetike, konservimit të germoplazmës, parandalimit të rrezikut të zjarreve, studime/vlerësime ekonomike dhe fizibiliteti të pyjeve e kullotave.
- c) **Shërbime profesionale për projektme:** projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës, plane mbarështimi të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, për pyllëzimet, fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje para komerciale e komerciale, të sistemimeve malore, përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpërse në to, të mbritshmërisë dhe ndërtimin e rrugëve pyjore.
- d) **Shërbime profesionale për zbatim:** të planeve te mbarështimit te pyjeve e kullotave, te projekteve për pyllëzimet, per fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje kulture, të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, te sistemimeve malore, te përmirësimit te kullotave dhe veprave ujeperse në to, te projekteve komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës, te mbritshmërisë dhe ndërtimin e rrugëve pyjore.

Neni 4

Çertifikimi i specialisteve

1. Certifikimi i specialisteve për njohuritë, aftësitë dhe përvojën, për kryerjen e veprimtarive profesionale, kryhet nga Drejtoria e Politikave te Pyjeve dhe Kullotave ne Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave

2. Certifikimi bazohet në dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Arsimi; Diploma Universitare
- b) Përvoja Profesionale; Kurikula personale (CV)
- c) Kualifikimi shkencor; Diplomat /titujt e fituar, certifikatat e trainimeve

Neni 5

Kriteret e certifikimit te specialisteve

Nr.	a. Arsimi diploma Universitare b. Përvoja c. Kualifikim shkencor	Veprimtaria që certifikohet
-----	--	-----------------------------

1	Inxhinier pyjesh me titull M s c. Doktor, Prof. as, Profesor.	a. Shërbime te ekspertizës dhe certifikimit
2	Inxhinier pyjesh me titull Doktor, Prof. as. Profesor.	b. Shërbime profesionale për studime e aplikime profesionale ne Pyje dhe kullota.
3	Inxhinier pyjesh	c. Shërbime profesionale për Projektme
4	Inxhinier pyjesh	d. Shërbime profesionale për Zbatime.

Neni 6 Tarifat e certifikimit

1. Tarifat e shërbimeve të Certifikimit janë:

- a) 100 (një qind) lekë për rastet e Certifikimit, për ndryshime në titullin e Certifikatës që kanë të bëjë me kriteret e certifikimit.
- b) pa pagesë për shërbimet e tjera të përcaktuara në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7 Kerkimi dhe dhënia e certifikates

1. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse. Formulari tip përmban, këto të dhëna (**Lidhja nr. 1** e cila është pjese e kësaj rregullore):

- a) të dhënat për identifikimin e kërkuarit (personit) që paraqet kërkesën;
- b) llojin dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë,
- c) të dhëna të tjera specifike (dokumente provuese), sipas kategorisë /nënkategorisë sipas nenit 5 te kësaj rregullore;
- ç) deklarin e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e Certifikimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);
- e) deklarin për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e certifikimit dhe do t'i përmbushë ato;
- ë) adresën për komunikim;
- f) listën e dokumenteve shoqëruese të paraqitura.

2. Formulari i plotësuar e i nënshkruar nga kërkuari bashkëlidhur dokumentet provuese, në kopje të njësuara me origjinalin, dërgohen me postë.

3. Bashkë me dokumentet shoqëruese paraqitet edhe një kopje e dokumentit të identifikimit të personit që ka nënshkruar formularin.

4. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, regjistrohet në regjistër, brenda ditës së punës që paraqitet kërkesa. Regjistri i certifikatave publikohet ne faqen e internetit te Ministrise.

Neni 8 Shqyrtimi dhe vendimmarrja për certifikatë

1. Drejtoria e Politikave te Pyjeve dhe Kullotave (Personi i ngarkuar) shqyrton, kërkesat sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe, në një afat prej 4 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës, bene vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të Certifikimit bazuar në vetëdeklarimet dhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuari.

2. Kërkesa refuzohet nëse nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet provuese, ato nuk janë derguar në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, ose kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme.

Neni 9 Përmbajtja e Certifikatës

1. Certifikata lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj. Titulli përmban, këto të dhëna:

- a) emrin dhe stemën e Ministrisë;
- b) serinë, numrin dhe datën e lëshimit;
- c) të dhënat për identifikimin e marresit;
- ç) llojin e veprimtarisë, dhe të përdorimit të saj;
- d) fusha e ushtrimit të veprimtarisë, (e përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë /nënkategorinë);
- e) afatin e vlefshmërisë (pa afat);
- ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të MMPAU dhe vulën përkatëse të institucionit;

2. Modeli i certifikatës është sipas lidhjes nr. 2, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Neni 10 Ankimi

1. Kerkuesi i interesuar mund të ankohet në rrugë administrative tek titullari i institucionit ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të personit të ngarkuar prej tij.

2. Ankimi shqyrtohet nga titullari i institucionit, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të nenit 30 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009. Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

3. Ankimi, në të gjitha rastet, paraqitet si dokument me shkrim, ose në mënyrë elektronike tek titullari i institucionit. Moskthimi i përgjigjes brenda 10 ditëve është miratim në heshtje.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Lufter XHUVELI

6. Formulari i Aplikimit

Tirane, me / 2009

Shkruaj me germa kapitale **EMERI MBIEMRI**

Rezidenca/adresa e plote, _____

Telefon / mobil / _____

E-mail _____

Me të cilën kërkoj të ushtrojë veprimtarinë, sipas nenit 5 te rregullores nr... date.....2009

Nr.	Kriteret	Dokumentet provuese	Kërkoje certifikate per veprimtarinë
1	Arsimi	<i>Diploma Universitare</i>	a.
2	Përvoja	<i>CV(personale)</i>	b.
3	Kualifikim shkencor	<i>Diploma ose titujt e fituar</i>	c. d.

V.O.(Plotësoni kutinë në krah të aplikimit që kryeni)

Deklaroj se angazhohem të njohë e të zbatoj të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në fushën e pyjeve dhe kullotave.

Deklarojë vërtetësinë e dokumenteve provuese dhe jam në dijeni të gjitha pasojave që mund të kemi si rezultat i deklarimeve të rreme apo paraqitjes së dokumenteve të pavërteta.

Nuk jam në marrëdhënie pune në institucione shtetërore aktiviteti i të cilave bie ndesh me ligjin Nr. 8549 datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil" dhe aktet e tjera nënligjore

Lista e dokumenteve të paraqitura

1. *Diploma Universitare(fotokopje e noterizuar)*
2. *CV personale*
3. *Diploma ose titulli i fituar(fotokopje e noterizuar)*
4. *Fotokopje e dokumentit identifikues (kartë identiteti apo pasaportë)*

Kërkuesi(**Emri Mbiemri, Nënshkrimi**)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE
DREJTORIA E POLITIKAVE TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

CERTIFIKATË

Nr.001

I jepet Z. _____

Për

- a. Shërbime të ekspertizës dhe certifikimit
- b. Shërbime profesionale për studime e aplikime profesionale ne pyje dhe kullota
- c. Shërbime profesionale për projektme
- d. Shërbime profesionale për zbatime

Leshuar me date/..../2009, Vlefshmëria pa afat.

DREJTORI

